



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 122/2013
Prishtinë, më 22.10.2013, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha–Shala, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Etem Arifi-anëtarë.

Munguan: Fikrim Damka dhe Visar Ymeri.

Pjesëmarrës i ftuar: Besim Kajtazi, drejtor i zyrës ligjor të Kryeministrit – ZKM;

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi–ZPRK dhe Burim Ejupi – INDEP.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 11.10.2013;
3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas pikave të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.10.2013;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 1.10.2013, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave;

Kryetari, i njoftoj deputetet së lidhur më Projektligjin për sistemin e lejeve dhe licencave, të gjitha komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar raportin me amendamente dhe nuk kanë vërejtje përveç Komisionit për Legjislacion. Komisioni për Legjislacion i ka sugjeruar Komisionit Funkcional që t'i rekomandojë seancës që të mos e miratojë projektligjin, pasi që sipas tyre projektligji, nuk ka bazë për procedim të mëtejshëm, sepse përmbajtja e projektligjit është në kundërshtim me nenin 79, të Kushtetutës dhe Ligjin për nismat legislative, me nenin 15, paragrafi 3, të projektligjit dhe me amendamentin 18, është përcaktuar autoriteti, me cilësi të agjencisë së pavarur, që mund të propozojë projektligje në Kuvend, e që është në kundërshtim me neni 79, të Kushtetutës; neni 3, përkufizimet në projektligj, nuk e kanë qartësinë e duhur normative dhe ngatërrohen nocionet “lajmërim, leje, lejim, regjistrim dhe person”. Po ashtu, është përdorur gabimisht përkufizimi “Person-person fizik apo subjekt ligjor”, sepse subjektet e së drejtës janë personat fizikë dhe juridikë. Edhe përmbajtja e përgjithësuar e neneve: 4,5,6.2, 7.2,19.3, 20, 21,32, kanë paqartësi të theksuar juridike dhe janë pa efekt normativ. Mirëpo, ai shtoi se kemi edhe një letër të ardhur dje nga Banka Botërore apo projekti i veçantë IFC, që kërkojnë që Ligji të miratohet.

Lutfi Zharku, tha se si grup i punës, e kemi krye punën tonë dhe gjatë gjithë kohës ia kemi tërheq vëmendjen komisionit se ky projektligj ka probleme të shumta dhe nuk do arrijmë të rregullojmë në masën e duhur, ndërsa kërkesa e Komisionit për Legjislacion është që të kthehet projektligji në ripunim sepse është në kundërshtim me Kushtetutën.

Besim Kajtazi-ZKM, tha se ne si Qeveri e kemi marrë rekomandimin e Komisionit për Legjislacion, përmes Komisionit Funkcional, pra komisionit tuaj. Ne propozojmë që vërejtjet që janë cekur saktë te neni 3 dhe 15.3, mund të përmirësohen dhe shtoi se nuk qëndron opinioni i Komisionit për Legjislacion, se janë në kundërshtim me Kushtetutën, ngase te neni 3, është lënë e qartë se “subjekti ligjor” nënkupton edhe personin fizik, ndërsa te neni 15.3, është e qartë se aty është bërë një gabim teknik, në vend të fjalisë “projekt akt” është shënuar “projektligj”.

Hashim Deshishku, tha se pavarësisht sa kemi punuar ne si komision, ne nuk mundemi të miratojmë ligj, i cili është në kundërshtim me Kushtetutën.

Kryetari, tha se Komisioni për Legjislacion edhe herëve të tjera ka nxjerrë rekomandime të tilla, mirëpo, nuk ka pas sukses të miratohen ato rekomandime, pas diskutimeve në seanca plenare. Kështu që, nganjëherë këto rekomandime po kanë orientim politik, andaj propozoj që të bëjmë një takim të përbashkët me Komisionin për Legjislacion, me Qeverinë me IFC-në dhe ekspertë të ndryshëm apo shoqërinë civile dhe mandej të dalim me opinion të qartë, se a duhet ky projektligj të miratohet apo ti kthehet Qeverisë në ripunim.

Sala Berisha Shala, theksoi se kur ta shikojmë Kushtetutën me të cilën është thirr Komisioni për Legjislacion, neni 79, thotë se kush ka të drejtë të propozojë projektligje si p.sh. Presidenti nga fushëveprimi i tij, Qeveria, Kuvendi dhe 10 mijë qytetarë, sipas ligjit për nismat legjislative, mirëpo, kjo nuk e ndalon që edhe ndonjë autoritet tjetër të bëjë ndonjë propozim ligj.

Hashim Deshishku, tha se Komisioni për Legjislacion nuk është komision politik, por është një prej komisioneve të tjera që jep rekomandime për çështje të Kushtetutës dhe ligjeve të tjera, pra në fushëveprimin e tij i shikojnë çështjet në aspektin juridik.

Teuta Sahatqija, e mbështeti propozimin e z. Deshishku, ndërsa, duke u thirr në letërën e IFC-së, edhe ata e ceku se nuk duhet që me akt nënligjor të rregullohet çështja e lejeve dhe licencave, por sidoqoftë, tha se ne duhet ti marrim vendimet vet e jo te presim nga të huajt, ndërsa u pajtua që të mbahet takimi i përbashkët me Komisionin për Legjislacion.

Shaip Muja, tha se pajtohet me propozimin që të takohemi në një mbledhje të përbashkët me Komisionin për Legjislacion dhe ti diskutojmë çështjet kontestuese. Mirëpo, tha se edhe Komisioni për Legjislacion nuk është dashur ta refuzoj ligjin në “on block” si kundër kushtetues, por të arsyetojë secilën dispozitë, që është në kundërshtim me Kushtetutën.

Ramiz Kelmendi, tha se duhet ti marrin parasysh komentet dhe propozimet e Komisionit për Legjislacionin, por edhe të Institucioneve financiare, siç është Banka Botërore apo IFC-ja, në këtë rast dhe mos të jemi të detyruar të miratojmë apo të refuzojmë Ligjin pa menduar mirë dhe mos të jemi peng e mospërqendrimit, por pas fushatës të kërkojmë kohë të takohemi me atë komision dhe të nxjerrim një Ligj sa më të mirë.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Të ftohet në një takim të përbashkët Komisioni për Legjislacion apo vetëm grupet e punës të dy komisioneve, që të harmonizohen qëndrimet e dy komisioneve në lidhje me projektligjin për sistemin e lejeve dhe licencave;
2. Autorizohet njësia mbështetëse e komisionit, që të koordinohet me njësinë mbështetëse të Komisionit për Legjislacion, që të krijojnë kushtet për takim.

4. Të ndryshme. Çështjet vijuese

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Zenun Pajaziti